



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DELVINË

**SHPALLJE PËR LËVIZJE PARALELE  
DHE PËR PRANIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL**

**Lloji i diplomës “Shkenca Shoqërore”, “Shkenca Juridike”, “Shkenca Natyrës” niveli minimal i diplomës “Master profesional”**

Në zbatim të nenit 22 dhe të nenit 25, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, si dhe të Kreut II, IV dhe VII të VKM nr. 243, datë 18/03/2015’Për pranimin, Lëvizjen paralele, perjudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” i ndryshuar me VKM –në nr. 746, datë 19.12.2018, **Drejtoria e Burimeve Njerëzore e Bashkisë Delvine** shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të pranimit në shërbimin civil për pozicionin:

- ☐ 1 (një), Specialist Informacioni, pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Bashkia Delvinë – kategoria VI-a;

**Pozicioni më sipër u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele!**

Vetëm në rast se, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se pozicioni është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil.

**Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive ) aplikohet në të njëjtën kohë**

<b>Afati për dorëzimin e dokumentave për LËVIZJE PARALELE:</b>	<b>28 Tetor 2021</b>
<b>Afati për dorëzimin e dokumentave për PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL:</b>	<b>02 Nëntor 2021</b>

## Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin më sipër është:

- 1 Të afishoj në pika të ndryshme me akses të gjerë publik në qytet njoftime informative të Bashkisë Delvinë.
- 2 Asiston qytetarët gjatë procedurës së përpilimit, protokollimit dhe delegimit të kërkesave në sistemin ONE STOP SHOP, ankesave ose aplikimeve me dokumentacionin shoqëruar, strukturave komponente të bashkisë.
- 3 Ofrimin e formularëve të aplikimit për kërkim informacioni për shërbime të ndryshme të ofruara nga institucioni.
- 4 Mbledhjen dhe pranimin e aplikimeve për kërkesë informacioni, apo ankesave nga qytetarët / grupet e interesit.
- 5 Ndhmon qytetarët në plotësimin e formularëve apo kur kanë pyetje mbi mënyrën e funksionimit të bashkisë.
- 6 Të mbledhë informacione për çdo njoftim, projekt apo veprimtari të sektorëve të bashkisë, të cilat i nevojiten për t'ia servirur qytetarëve, institucioneve të ndryshme që operojnë me bashkinë Delvinë, komunitetit të biznesit etj.
- 7 Te ndryshme.

## 1 LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

### 1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kushtet minimale që duhet të plotësojë kandidati për këtë procedurë janë:

- a) Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori për të cilën aplikon;
- b) Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c) Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”;
- ç) Të plotësojë kriteret e veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si më poshtë:

d) Te zoteroje diplome te nivelit “**Master profesional “Shkencat Juridike,Shkencat Shoqërore,Shkencat Natyrës.** Edhe diploma e nivelit Bachelor te jete ne te njejten fushe .

**Tjetër:** Te kete mbi 1 vit vjetersi pune .

- Të ketë njohuri mbi programet bazë të punës në kompjuter.
- Të ketë aftësi të mira komunikuese, koordinuese dhe të punës në grup.

## **1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

---

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Delvine , dokumentat si më poshtë:

a-Jetëshkrim i plotësuar

b-Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor).Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sporteve.

c-Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);

d-Fotokopje të letërnjoftimit (ID);

e-Vërtetim të gjendjes shëndetësore;

f- Vërtetim të gjendjes gjyqësore;

g-Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;

h-Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.

i-Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

***Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 28.10.2021***

Bashkia Delvine  
Drejtoria e Burimeve Njerëzore  
Lagjia "Sinan Ballaci "  
Rruga "Nazif Haderi "

## **1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**

---

Në datën **01-11-2020**, Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Delvine do të shpallë në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit" dhe në stenden e Bashkisë Delvine , listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën ,vendin dhe oren e sakte ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Delvine , nëpërmjet adresës së e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

## **1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA**

---

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohurite mbi Ligjin Nr 139, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendor "
- Njohurite mbi Ligjin nr.152/2013 "Për nëpunësin civil"i ndryshuar .
- Njohurite mbi Ligjin nr. 9131, dt. 08.09.2003 "Për rregullat e Etikës në Administratën Publike".
- Njohurite mbi Ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".

## **1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

Kandidatet do të vleresohen për përvojën , trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën , si dhe çertifikimet pozitive .

Totali i pikeve për këtë vlerësim është 40 pike.

**Kandidatet gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vleresohen në lidhje me :**

- a- Njohuritë , aftësitë , kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës ;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme ;
- c- Motivimin , aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën .

Totali i pikeve për këtë vlerësim është 60 pike.

## **1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Delvine do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të Bashkisë.

Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për shpalljen e fituesit.

## **2 PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL**

Vetëm në rast se pozicionet e renditura në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezultojnë ende vakante, ky pozicion është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

Këtë informacion do ta merrni në faqen e Shërbimit Kombëtar të Punësimit , dhe në faqen zyrtare të Bashkisë Delvine duke filluar nga data **01.11.2021**

### **2.1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA**

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë shërbimit civil të cilët plotësojnë kërkesat e nenit 21 të ligjit nr. 152/2013 i ndryshuar .

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil janë :

- a) Të jetë shtetas shqiptarë;
- b) Të ketë zotësi për të vepruar ;
- c) Të zotërojnë gjuhën shqipe , të shkruar dhe të folur ;
- d) Të jetë në kushte shëndetsore që lejojnë të kryejnë detyrën teknike përkatëse;
- e) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për të kryerjen e një krimi apo për

- kryerjen e nje kundravajtje penale me dashje;
- f) Ndaj tij te mos jete mare masa disiplinore e largimit nga sherbimi civil , qe nuk eshte shuar sipas ligjit 152/2013 “Per nepunesin civil “ i ndryshuar .

Kandidati duhet te plotesojne kriteret e veçanta si vijon :

a-Te zoteroje diplome te nivelit “**Master profesional** “ne “**Shkencat Juridike**” ,”**Shkencat Shoqërore**” ,”**Shkencat Natyrës**”. Edhe diploma e nivelit Bachelor te jete ne te njejten fushe .

**Tjetër:** Te kete 1 vit vjetersi pune.

Të ketë njohuri mbi programet bazë të punës

Të ketë aftësi të mira komunikuese , koordinuese dhe të punës në grup.

## **2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

---

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

a-Jetëshkrim i plotësuar .

b-Fotokopje të diplomës dhe lister notash (përfshirë edhe diplomën bachelor, te noterizuara).Për diplomat jashtë Republikës së Shqipërisë të jetë njehsimi pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve.

c-Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);

d-Cdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

e-Fotokopje të letërnjoftimit (ID);

f-Vërtetim të gjendjes shëndetësore;

g-Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore / Vërtetim të gjendjes gjyqësore.

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumentave të cituara më sipër, do të bëhet në Bashkinë Delvine .

**Dokumentat e aplikimit duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës**

**02.11.2021** në adresën

**Bashkia Delvine**

**Lagjia “Sinan Ballaci “**

**Rruga “Nazif Haderi”**

## **2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT TË DOKUMENTACIONIT**

---

Në datën **12.11.2021**, Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Delvine do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, dhe ne faqen zyrtare te Bashkise Delvine listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e pranimit ne kategoria ekzekutive , si dhe datën, **vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.**

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në shërbimin civil dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Bashkia Delvine , për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

## **2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI ME SHKRIM DHE INTERVISTA**

---

Kandidatët do të testohen me shkrim në lidhje me:

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuri mbi Ligjin nr. 139 , datë 15.07.2017 “ Për vetëqeverisjen vendore “
- Njohuri mbi Ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”.
- Njohuri mbi Ligjin nr. 9131, dt. 08.09.2003 “Për rregullat e Etikës në Administratën Publike”
- Njohuri mbi Ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”

**Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionet;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

## **2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

**Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:**

- a- deri në 60 pikë për vlerësimin me shkrim
- b- Intervistën e strukturuar me gojë që konstiton në motivimin , aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën , deri në 25 pike.
- c- Jetëshkrimin , që konstiton në vlerësimin e arsimimit të parësor dhe të trajnimeve , të lidhura me fushën, deri në 15 pike.

## **2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Delvine do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe stenden e Bashkisë Delvine . Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e konkurimit, do të marrin informacion për fazat e mëtejshme të procedurës së konkurimit në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” si dhe në faqen zyrtare të Bashkisë Delvine :

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit të dokumentacionit ,
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme portalin e “Shërbimit Kombëtar të Punësimit” dhe faqen zyrtare të Bashkisë Delvine duke filluar nga data 12.11.2021.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
B A S H K I A D E L V I N Ë  
DREJTORIA E PERSONELIT DHE BURIMEVE NJERËZORE**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Delvinë, më \_\_\_\_/\_\_\_\_/2021

**Lënda :** Dërgohet njoftim për publikim

**Drejtimi :** Shërbimit Kombëtar të Punësimit

**T I R A N Ë**

**Përshëndetje dhe punë të mbarë !**

Bashkalidhur shkresës po ju dërgojmë për publikim në portalin tuaj , njoftim për përfundimin e procedurës për pranimin nga jashtë shërbimit civil për pozicionin për kategorinë ekzekutive , “ Specialist Informacioni ” në Bashkinë Delvinë .

Nga ana e jonë është dërguar dhe në rrugë elektronike në adresën tuaj “vendetelirapune@shkp.gov.al”.

Për çdo paqartësi na komunikoni ne adresën [bashkia.delvine@hotmail.com](mailto:bashkia.delvine@hotmail.com) , ose numër kontakti 0688058283.

**Ju faleminderit për mirëkuptimin !**

**KRYETARI I BASHKISË**

**Majlinda Qilimi**



**BASHKIA DELVINË**  
**DREJTORIA E PERSONELIT DHE BURIMEVE NJERËZORE**  
**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**NJOFTIM VETËM PËR NËPUNËSIN CIVILË**

**PËR LËVIZJEN PARALELE**

?

Drejtoria e Personelit dhe Burime Njerëzore të Bashkisë Delvinë në bazë të nenit 22 të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin Civil “ i ndryshuar dhe pikës 1 të Kreut II të VKM 243,datë 18.03.2015 “ Për pranimin lëvizjen paralele , periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” njoftojmë për përfundimin e procedurës “Lëvizja paralele “ i ndryshuar për kategorinë ekzekutive në pozicionet;

☒ 1 (një) ,Jurist ,në Zyrën e Juridike – kategoria VI-a;

Në këto kushte plotësimi i këtyre vendeve të lirë pune do të vazhdojë me procedurën e pranimin në shërbimin civil.

Njoftimi i aplikantëve për këtë procedurë(për rezultatet e fazës së verifikimit të dokumentacionit) do të bëhet në faqen e Shërbimit Kombëtar të Punësimit dhe në stendën e faqen zyrtare të Bashkisë Delvinë duke filluar nga data 11.09.2020.

**BASHKIA DELVINË**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA DELVINË**  
**DREJTORIA E PERSONELIT DHE BURIMEVE NJERËZORE**

**NJOFTIM**

**PËR PRANIMIN NGA JASHTË SHËRBIMIT CIVIL**  
**PËR POZICIONIN**

1 (një) ,Jurist ,në Zyrën e Juridike – kategoria VI-a;

Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Delvinë në bazë të nenit 22 të ligjit nr.152, datë 152/2013”Për nëpunësin civil “i ndryshuar dhe VKM-së nr.243, datë 18.03.2015 “Për pranimin lëvizjen paralele, perjudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” i ndryshuar njoftojmë për përfundimin e procedurës pranimit nga jashtë shërbimit” për kategorinë ekzekutive pa aplikant .

**BASHKIA DELVINË**